



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 17, pika o) dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika i) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 22.12.2023, merr këtë

**V E N D I M**

1. Miratohet lirimi nga pagesa për pjesëtarët e Policisë së Kosovës për shërbimet që ofrohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore që menaxhohen nga Kryeqyteti.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Shëndetësisë dhe institucionet vartëse të Drejtorisë së Shëndetësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-020/01-238142/23, më 28.12.2023

**KRYESUES I KUVENDIT**  
**Pëllumb Bajcinovci**

